

### Konkluzione dhe sugjerime për hapat më tej

Lidhur me tryezën zhvilluar datë 23 November 2021, organizuar nga DMO-Albania në kuadër të projektit “Rritje e ndërgjegjësimit dhe lobim te politikbërësit për modelin e zhvillimit të DMO-ve në Shqipëri”, mbështetur nga projekti IdeAL i Co-Plan, Instituti për zhvillimin e Habitaveve, financuar nga BE:

Ne si: **DMO Albania (organizatë konsulente, Ojff); Visit Tirana (iniciative private); Co-PLAN, Instituti për zhvillimin e habitaveve (donator); Risi Albania (donator); Visit Gjirokastra (Ojff, partneritet publik privat); Visit Saranda (partneritet publik-privat)**, - si aktorë që kemi punuar në të njëjtën linjë për të ngritur organizata të partneritetit publik-privat për menaxhimin e destinacioneve turistike:

- Jemi shumë të lumtur që më në fund u hap debati kombëtar me gjithë grupet e interesit për një kornizë ligjore për ‘Organizatat për menaxhimin e destinacioneve’ (OMD ose DMO ne anglisht), bazuar në Strategjinë e Turizmit të Qendrushëm 2019-2023, Objektivi 5 (Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve 5.1; Konsolidimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin dhe operimin e OMD)
- Jemi plotësisht dakord me sugjerimin e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit znj. Mirela Kumbaro, që të nisë konsultimi në nivel qarku, për të diskutuar me gjithë grupet e interesit për të nxitur partneritetin public-privat-komunitet (P-P-C), për të ezauruar mekanizmat brenda ligjeve aktuale për të menaxhuar destinacionet dhe për të pare më tej mundësitë për ndërhyrje ligjore apo ligj të ri. Mendojmë se është më shumë vlerë konsultimi në nivel qarku, pasi OMD-te duhen parë ‘rajonale’ dhe jo në nivel bashkish të vogla, pasi prodhojnë më shumë turizëm dhe të ardhura dhe e mbajnë më gjatë turistin në destinacion përmes paketave më të plota dhe të larmishme turistike.
- Jemi shumë të entuziazuar nga gjithë debati i hapur dhe konstruktiv i gjithë aktorëve: Ministri e Turizmit dhe Mjedisit, institucione varesie AKT, AKB, aktorë lokalë, shoqëri civile e donatorë etj.-ku rezultoi një mendim i sinkronizuar se **destinacionet duhet të menaxhohen dhe brandohen lokalisht**, pasi lokalët njohin mirë potencialet, nevojat dhe problematikat dhe mund të përshtaten më mirë me krizat e ardhshme.
- Jemi gjithashtu në një mendje se, menaxhimi efektiv dhe afatgjatë i një destinacioni bëhet nëse ulen vazhdimisht bashkë, sa herë të jetë e nevojshme, në një tryezë gjithë aktorët lokalë, përfshi Bashki, prefekturë, institucione të tjera kulturore e të mjedisit, tur operatorë, hotele, restorante, e biznese të tjera turistike, shoqëri civile e madje dhe komunitet. Ky duhet të jetë një proces i pandërprerë, me aktorë të qëndrueshëm lokalë dhe jo të ndalet në varësi të ndryshimeve politike çdo 4 vjet.
- Debati lidhur me mbijetesën e DMO-ve aktuale nuk ka të bëjë vetëm me **mbështetjen financiare**, pasi ka donatorë që ende po i mbështesin për momentin. Debati në thelb ka të bëjë:
  - me përfshirjen e plotë të aktorëve lokale të turizmit në vendimarrjen për turizmin në destinacion,

- në marrjen e një roli të rëndësishëm të këtyre organizatave, në bashkëhartimin e strategjisë së turizmit të destinacionit, në mbledhjen dhe analizimin e statistikave të turizmit, në krijimin e produkteve turistike duke përfshirë gjithë bizneset e turizmit edhe në zonat rurale, në bashkëhartimin e kalendarit të eventeve, në kalendarin e promovimit, cilat zona kanë nevojë për turistë (shpërndarjen e turistëve dhe të ardhurave), në organizimin e eventeve, panairove, por dhe në menaxhimin në rast krize si ajo e pandemisë për të gjetur rrugët e mundshme të vazhimit të turizmit, gjetjes së tregjeve të reja, apo mbështetjes së bizneseve lokale, në trajnime, punesime etj etj. Që të menaxhohet mirë dhe jo në mënyre kaotike një destinacion, këto çështje duhet të diskutohen dhe vendosen në një strukturë të posacme, të qëndrueshme, gjithpërfshirëse, pra në një grupim të gjithë aktorëve.
- Lidhur me partneritetin publik- privat në çdo destinacion ka disa pyetje që kërkojnë përgjigje:
  - Çfarë kriteri duhet të kenë këto partneritete, organizata, që të njihen nga Bashkia, apo Bashkitë e Qarkut, dhe të pranohen si aktorë të rëndësishëm për menaxhimin e destinacionit. Psh do jetë vetëm një portal për brandimin e qarkut apo disa, do jetë vetëm një grupim që do përfaqësojë gjithë qarkun në panairë, apo disa? Do lihet në vullnetin e Bashkisë apo prefekturës që rolin për menaxhimin dhe marketimin e turizmit në atë destinacion, ta marrë një organizatë, do ta menaxhojë vetë Bashkia, apo do jenë njëherësh disa organizata, grupime?
  - Sa organizata të tilla mund të ketë një destinacion, a duhet Bashkia apo Prefektura e Qarkut të mbështesë çdo projekt të ngjashëm, duke krijuar mbivendosje funksionesh të organizatave të tilla?
  - Kur ndryshon pushteti në nivel qendror apo lokal, në njërin apo tjetrën Bashki të Qarkut, kush duhet të garantojë vazhdimin e zbatimit të strategjisë, aktiviteteve, mbledhjes së statistikave, perfaqesimit në panairë etj?. A i duhet lënë më shumë vend privatit në këto organizata dhe roli i bashkisë të jetë suportues, facilitues?
  - Çfarë do ndodhë për OMD në nivel qarku? Çfarë roli mund të ketë prefekti, apo kryetarët e secilës bashki të qarkut lidhur me këto OMD?

Ndërsa konsultimi publik do të nisë në gjithë vendin, në sugjerojmë që fillimisht të kuptohet mirë nga gjithë aktorët se çfarë janë OMD, dhe ku ndryshon roli i tyre nga çdo partneritet tjetër apo organizatë tjetër në destinacion.

Në gjithashtu sugjerojmë, që përveç modeleve të huaja, që ekzistojnë pa fund, të mund të shihen dy ligje shqiptare që mund të përdoren si referenca për krijimin e një strukture për menaxhimin e destinacioneve turistike në nivel qarku.

**1. Ligji për TID (që rregullon një bashkepunim publik-privat vetem per zonat BID, qendrat historike)**

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200601110827ligj%20nr.%2063,%20dt.%2014.5.2020.pdf>

**2. Projektligj për zonat Leader dhe Grupet Vendore të Veprimit për bujqësinë, që pritet të miratohet së shpejti (dhe që rregullon një partneritet publik- privat, ku shteti nuk ka më shumë se 49% të votës, por që rregullon shumë çështje të vendimarrjes së fermerëve nga poshtë-lart në një territor të caktuar).** <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/429>

Kur ka partneritete të tilla për bujqësinë dhe zonat muzeale TID, përse të mos ketë një organizim të tillë për menaxhimin e turizmit në nivel qarku. Turizmi dhe bujqësia janë potencialet kryesore të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, dhe ka ardhur koha që vendimarrja dhe vizioni të vijë nga poshtë-lart.

Edhe në zonat UNESCO, ku ka plan menaxhimi apo struktura menaxhimi, për garantimin e ruajtjes së Vlerave Universale të tyre, udhëzimet e UNESCO kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen e aktorëve dhe gjithë komuniteteve në ruajtjen e këtyre pasurive dhe në vendimarrje, veçanërisht kur bëhet fjalë për turizmin në këto zona, pasi ai duhet të zhvillohet në mënyrë të kujdesshme pa dëmtuar destinacionin, por dhe duke mundësuar maksimizimin e përfitimeve për komunitetin nga kjo pasuri UNESCO. Në shumë vende të botës, në menaxhimin e pasurive UNESCO, me ngritjen dhe të shqetësimeve për overtourism, cdo vendim që nga menaxhimi i fluksit të vizitorëve, shpërndarja e tyre, mbajtja në destinacion për të kënaqur dhe bizneset turistike përreth, etj, merren në përputhje me dakordësinë e gjithë aktorëve lokale. Në këtë këndvështrim, një punë e madhe duhet bërë për edukimin e aktorëve lokale, trajnime të vazhdueshme të tyre për të kuptuar rëndësinë e destinacionit ku jetojnë.

***Shumë faleminderit dhe jemi gati të bashkëpunojmë në çdo kohë për OMD-të në Shqipëri!***

- 1. DMO ALBANIA**
- 2. Risi ALBANIA**
- 3. Visit Gjirokastra**
- 4. Visit Tirana**
- 5. Visit Saranda**
- 6. Co-PLAN, Instituti për zhvillimin e habitateve**